

SISTEMIMI NË SHKOLLË KONTRIBUTI I BABAIT PRINDËRIT U NDIHMOJNË FËMIJËVE TË RUHEN, TË JENË TË LUMTUR DHE TË MËSOJNË



NJIHENI FËMIJËN TUAJ NËSE DONI TA NDIHMONI NË MËSIM

Është e habitshme se sa shumë gjëra nuk i vërejmë te fëmijët tanë. Eksperimenti në vazhdim bëhet për ta kuptuar më mirë botën e tyre, gjë që është qenësore për t'i ndihmuar ata në mësim.

Jepjani vetes një javë për t'iu përgjigjur këtyre 20 pyetjeve:

1. Kush janë tre shokët më të ngushtë të fëmijës tuaj?
2. Cila është loja më e dashur e fëmijës tuaj?
3. Thoni emrat e dy lodrave prej pelushi të fëmijës tuaj.
4. Çfarë pëlqen fëmija juaj në rutinë e vet të ushqimit?
5. Cilat fjalë di t'i lexojë fëmija juaj?
6. Në çfarë ore fillon dhe mbaron shkolla?
7. A ka frikë fëmija juaj nga seriali Doctor Who?
8. Cilën edukatore e ka dashur fëmija juaj më së shumti?
9. Cila ka qenë dhurata më e rëndësishme e ditëlindjes së fëmijës tuaj?
10. A përdor fëmija juaj breza apo jastëkë ajri në krahë kur noton në pishinë?
11. Cili është programi televiziv më i dashur i fëmijës tuaj?
12. Përmendni diçka që ka bërë fëmija juaj në shkollë.
13. Sa peshon fëmija juaj?
14. Sa i gjatë është fëmija juaj?
15. Cilit instrument ka dëshirë t'i bjerë fëmija juaj?
16. A i pëlqen fëmijës tuaj më shumë ngjyrosja apo vizatimi?
17. Çfarë ushqimi i pëlqen fëmijës tuaj për mëngjes?
18. Cila është bluza më e dashur e fëmijës tuaj?
19. Cila është ngjyra më e dashur e fëmijës tuaj?
20. Çfarë bën fëmija juaj në kohën e lirë?

KËSHILLAT KRYESORE

Nëse doni të ndihmoni që fëmijët tuaj të mësojnë në shtëpi (apo të shkoni në shkollë kohë pas kohe), atëherë është e rëndësishme që të krijoni një barspeshë të kohës që ju merr puna dhe qëndrimi në shtëpi.

PËRGJIGJET PËR DISA PREJ PROBLEMEVE

Pyetje: Si të shkëputem prej punës?

Përgjigje: Mundohuni që në gjysmëorën e fundit të punës t'i shmangeni punëve stresuese. Dëgjoni muzikë gjatë rrugës për në shtëpi. Zhvilloni një ritual të 'kthimit në shtëpi' – për shembull nëpërmjet një përshëndetjeje të fuqishme, duke dëgjuar me vëmendje përmbledhjen e ditës së fëmijës tuaj. Pastaj, merrni pak nga 'koha juaj' – ndoshta për t'i ndërruar rrobat tuaja.

Pyetje: Si mund të kaloj më shumë kohë në shtëpi?

Përgjigje: Mendoni mirë se çfarë lirish dëshironi (p.sh. të vendosni vetë kur do të filloni/mbaroni punën, të keni katër ditë më të gjata, etj.) dhe kontrolloni mundësitë që ofron punëdhënësi juaj. Lëri mënjane punët e parëndësishme ose aktivitetet e lira. Shkurtoni kohën e udhëtimeve: lëvizeni punën – ose shtëpinë tuaj – më afër.

Pyetje: Po nëse më streson puna?

Përgjigje: Nja njëqind metra përpara se të arrini në shtëpi, kujtohuni se stresi mund t'ju inatosë dhe t'ju bëjë më të ftohtë ndaj fëmijëve – por dhe ndaj partnerit tuaj. Merrni frymë thellë, përqendrohuni tek fytyra e fëmijës tuaj dhe lëri mënjane vështirësitë e ditës. Nëse s'jeni ende gati, bëjeni një shëtitje të vogël përpara se të hyni në shtëpi.

Pyetje: Po nëse jam i papunë?

Përgjigje: Një studim që kishte për temë fëmijët me prejardhje nga familjet e varfëra, por që kishin ecur mirë në jetë, ka vënë në pah se një pjesë e tyre kishin pasur baballarë të papunë, por që ishin përkujdesur shumë për ta. Papunësia mund t'ju shuajë vetëbesimin – mos lejoni që ajo t'ju largojë nga fëmijët tuaj.

Pyetje: Cila është mënyra më e mirë për t'i dhënë zemër fëmijës tim?

Përgjigje: Më e rëndësishmja është që t'i kushtoni vëmendje, ta dëgjoni dhe ta lavdëroni. Nëse fëmija juaj ju tregon diçka që ka bërë, thojni “Paske punuar shumë për ta bërë këtë”. Nëse ju nguteni dhe i thoni “Sa bukur e paske vizatuar makinën” përderisa fëmija ka vizatuar anijen, fëmija do të mendojë se nuk di të vizatojë anije. Informohuni më shumë tek organizata I CAN, e cila i ndihmon fëmijët dhe të rriturit të komunikojnë me njëri-tjetrin – www.ican.org.uk.

PESE SYNIMET E BABIT

1. Lajmërohuni vullnetarisht që të ndihmoni në organizimin e një udhëtimi shkollor.
2. Mbikëqyrni ecurinë e fëmijës tuaj në shkollë.
3. Gjejini gazetën e shkollës – ose kërkoni t'ju dërgojnë me anë të postës elektronike.
4. Lexoni me fëmijën tuaj, ndihmoheni me testet e gjurmimit.
5. Mësoni diçka bashkë – shembull t'i bini një instrumenti muzikor.

Kontakte të dobishme për babin:

Parentline Plus Këshillim për babin dhe mamin

0808 800 2222 (telefon kujdestar 24 orë në ditë)

www.parentlineplus.org.uk

Centre for Separated Families Mështetje për babin dhe për mamin

01904 610321

www.separatedfamilies.org.uk

Child Support Agency Informacione dhe këshillime të përgjithshme

08457 133133

E-maili: csa-nel@new100.dss.gsi.gov.uk

Citizens Advice Qendra të mrekullueshme këshillimi, sidomos për çështjet ligjore dhe të ndihmave sociale, me informacione që përditësohen vazhdimisht

020 7833 2181

www.nacab.org.uk

Daycare Trust Telefon kujdestar për përkujdesjen e fëmijëve

020 7840 3350

www.daycaretrust.org.uk

Families Need Fathers Baballarët që e kanë përjetuar ndarjen u japin këshilla baballarëve të porsandarë

Tel 08707 607496 (6pm-10pm)

www.fnf.org.uk

Fathers Direct Qendra Kombëtare e Informacionit për atësinë

www.fathersdirect.com

Gingerbread Këshillim për baballarët dhe nënat e vetmuara

0800 018 4318)

www.gingerbread.org.uk

National Debt Helpline Këshillime për borxhe, me ruajtje të garantuar të fshehtësisë

0800 808 4000

www.nationaldebtline.co.uk

National Family and Parenting Institute Raporte dhe broshura

020 7424 3460

www.nfpi.org

NHS Direct Këshillime për çështjet shëndetësore 24 orë në ditë

0845 4647

www.nhsdirect.nhs.uk

Relate Ndihmë për çiftet në lidhje partneriteti

01788 573241

www.relate.org.uk

Resolution Listë e avokatëve që merren me ligjin familjar

01689 850227/ 0345 585671

E-mail: info@sfla.co.uk

Respect Këshillime në raste të dhunës dhe keqtrajtimit

020 8563 8523

Email: info@respect.uk.net

Sure Start Informacione mbi shërbimet lokale që u kushtohen prindërve

0800 096 0296

www.surestart.gov.uk

Website të tjera

www.dfes.gov.uk

www.bbc.co.uk/parenting

www.practicalparent.org.uk

www.raisingkids.co.uk

Ju lutemi shënojeni në vazhdim njoftimet lokale dhe mundësitë e kontaktimit

Të gjitha të drejtat e rezervuara © Crown, gusht 2006.